



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 801/3 Prot.

Tiranë, më 14 / 06 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 73, Datë 14 / 06 / 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 61, datë 29.05.2019, të Th.G kundër Shoqërisë “Albacall” sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga Th.G, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës dhe dokumentet bashkëngjitur, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Në muajin mars 2017 është zhvendosur brenda shoqërisë “Albacall” nga fushata “Wind” në fushatën “Tim”, bashkë me një grup prej 8 personash. Në momentin e zhvendosjes ndryshe nga 8 personat e tjerë që kanë zhvilluar mbledhje me Burimet Njerëzore, ai ka marrë vetëm një telefonatë, në të cilën nuk i është komunikuar asnjë arsye. Ankuesi deklaroi se, ambienti në fushatën “Tim” ishte mbytës, jo stimulues dhe kjo si pasojë e frymës shtypëse të Duty Menagerit, E.M, i cili ka një komunikim fyes dhe jo profesional me operatorët. Ankuesi shprehet se dhe supervizorja A.Z ka patur një sjellje përçmuese dhe denigruese ndaj tij, duke e paragjykuar dhe duke mos e lënë të bëjë orë shtesë apo të marrë bonus personal. Ankuesi informon se akti final i diskriminimit të tij ka qenë pushimi nga puna<sup>1</sup> për shkak të një gabimi në sistem”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

**II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

<sup>1</sup> Me shkresën nr. 2910/9/2018, datë 29.10.2018, Th.G është njoftuar nga punëdhënësi për zgjidhjen e kontratës së punës për arsye të kryerjes së punës në mënyrë jo konforme me rregullat dhe procedurat duke i sjellë dëmë aktivitetit dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare në datë 31.12.2018.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përbërje, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në formularin e ankesës dhe në kopjen e Kërkesë-Padisë<sup>2</sup> së depozituar pranë KMD-së, bashkëlidhur ankesës, rezulton se subjekti ankues, pretendimin e tij për diskriminim nga ana e Shoqërisë “Albacall” sh.a e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në objektin e kërkesë padisë, subjekti ankues në pikën 2 të saj ka kërkuar: *“Detyrimin e palës së paditur Shoqëria “Albacall” sh.a të dëmshpërblejë paditësin Th.G, për dëmet pasurore dhe jopasurore të pësuar si pasojë e diskriminimit në punë”.*

Subjekti ankues në kërkesë padinë drejtuar gjykatës ka ngritur pretendimin se është shkelur dhe ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminim”, duke cituar konkretisht, nenin 1 “Objekti”, nenin 2 “Qëllimi” dhe nenin 12, pikën 1/c “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim. Ndalimi i diskriminimit”.

Bazuar në sa më sipër, Th.G në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pretenduar trajtimin diskriminues nga ana e punëdhënësit, Shoqëria “Albacall” sh.a.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të*

<sup>2</sup> Kërkesë Padi e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 21.02.2019.

*qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”*

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 61, datë 29.05.2019, të shtetasit Th.G kundër punëdhënësit, “Albacall” sh.a.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**